ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr[1] i prokurimit	**622-24-9140-5-1-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: "Ndërtimi i shtëpisë emergjente për mbrojtjen e fëmijeve".

ANKESË

1. **Identifikimi i ankuesit***

EBK SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga:Bujar Godeni p.n. - Prizren

(Adresa)

Prizren — *20000*

(Vendi) — *(Kodi postar)*

049/509-237 — *N/A*

(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Flamur Shefiku

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ebkosova@gmail.com
(Adresa elektronike)

28.02.2025
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

EBK SH.P.K. PRIZREN

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. **Identifikimi i avokatit**

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë 04.09.2024
Hapja e ofertave: 14.10.2024
Njoftimi mbi vendimin e AK: 07.11.2024
Kërkesa për rishqyrtim dt.12.11.2024
Vendimi për refuzim dt.14.11.2024
Ankesa në OSHP dt.25.11.2024
Ekspertiza nr. dt.05.12.2024 Nr. 2024/1146
Vendimi i OSHP-së Nr. 2024/1116 dt.27.01.2025
Njoftimi mbi vendimin e AK: 14.02.2025
Kërkesa për rishqyrtim: 19.02.2025
Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 21.02.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi **mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja **preliminare e mosmarrëveshjeve**

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

7. Dispozitat **e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 10 i LPP-së
Neni 11 i LPP-së
Neni 56 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 40 i RRPP Nr.001/2022

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë **detale mbi faktet dhe argumentet**

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kronologji

Me dt. 07.11.2024 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së ku ishte anuluar aktiviteti i prokurimit me arsyetimin si më poshtë:

Nuk kemi asnjë asnjë ofert te pergjgjegjshme: Komisioni i vlerësimit te ofertave rekomandon qe ky tender te Anulohet sepse ne paramasen dhe parallogarin e gjenden pozicione tek Ujesjellesi dhe kanalizimi 1. Ujësjellësi pozicioni 2.6 eshte shënuar 435, qe nuk korrespondon me asnjë pozicion (te përmirësohen paramasat nga projektanti i Autoritetit kontraktues.
Ne paramase te pozicioni Intalimeve makinerike te përmirësohen pozicionet Pozicioni A; Pika 5 pika 14 ; Pozicioni B , Pika 33, sepse kemi pozicione te dyfishta.

Ne kishim pranuar letrën standarde për tenderues të eliminuar.

Kundër këtij njoftimi ne kishim parashtruar kërkesë për rishqyrtim me dt.12.11.2024 dhe më pastaj ankesë në OSHP me dt.25.11.2024.
Vendimi i OSHP-së Nr. 2024/1116 i dt.27.01.2025 e kishte kthyer lëndën në rivlerësim, duke aprovuar pjesërisht ankesën tonë si të bazuar.

Pas rivlerësimit është nxjerr njoftimi mbi vendimin me dt.14.02.2025 ku është rekomanduar për kontratë OE ALBOSS SH.P.K me çmimin e ofruar prej; 615451.16 euro (i korrigjuar), ndërsa neve na është dërguar letra standarde për tenderues të pasuksesshëm.

Edhe tek raporti i vlerësimit është shënuar se sipas vendimit të OSHP-së është ndërmarr ky veprim, mirëpo sqarojmë e OSHP-ja nuk ka dirigjuar procesin se kujt duhet ti jepet kontrata, prandaj ky arsyetim është i paqëndrueshëm.

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë ALBOSS"SH.P.K., Grejkoc, Suhareke, 23000, GREJKOVC, është i papërgjegjshëm, prandaj arsyet të cilat i ka cekur AK-së për ofertën e këtij grupi janë edhe pretendime tona ankimore.

Neve nuk na është lejuar qasje e plotë, në ofertën e këtij grupi të OE, me arsyetimin se i njëjti ka kërkuar që të jenë sekret afarist dokumentet sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së, mirëpo ne nuk kemi pa që është arsyetuar një kërkesë e tillë e po ashtu AK-ja nuk ka përgatit versionin e pastruar të dokumenteve duke bërë shkelje ligjore të nenit 10 dhe 11 të LPP-së.

Papërgjegjshmëria e këtij grupi të OE është si më poshtë:

I autorizuari zt. M N. I mungon autorizimi nga operatori ekonomik I cili ka lidhur kontrata ne emer te biznesit me Ingjinieret e prezantuar ne ofert.
Gjithashtu pasi nuk kemi qasje ne dokumentet e ofertes se OE kërkojmë verifikim për të gjitha kontratat apo marrveshjet e bashkpunimit nëse nënshkrimi është bërë nga persona të tretë të ofrohet autorizimi nga kompania që ata persona janë të autorizuar të marrin veprime në emër të kompanisë.

Në kuadër të stafit Profesional duhet të Caktohen

a. Menaxheri i projektit i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë

drejtimi i Konstruktiv ose master i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv - me jo më pak se 6 vite përvojë pune në profesion. Të jetë i certifikuar si Ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë.

Dëshmia 2; 1. Duhet te caktohet me vendimi menaxheri i projektit CV-ia e nënshkruar nga vetë inxhinieri, diploma e menaxherit, dëshmi mbi përvojën në punë, Certifikatë SSHP (Ekspert për siguri dhe Shëndet në Punë).Certifikate për mbrojtje nga zjarri ,

Dyshojmë se kompania në fjalë posedon një inxhinier të ndërtimtarisë me certifikatë SSHP, andaj nëse ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për projektin në fjalë do ishte absurde pasi që punët që duhet ti kryej një menaxher i një projekti janë punë të përditshme dhe punë me dinamikë të madhe për të cilat inxhinieri i ndërtimtarisë i certifikuar me SSHP me marrëdhënie pune me ndonjë kompani tjetër nuk mund të arrij që të kryej me përgjegjësi dhe përgjegjshmëri detyrat e tij si menaxher i projektit. Kërkojmë nga OSHP-ja që të analizojë këtë fakt pasi që ne si OE nuk kemi pasur qasje në dokumente të këtij grupi të OE.
Pretendimi jonë bazohet duke pasur parasysh njohuritë që i kemi për këtë kompani nga tenderët e kaluar por kërkojmë që të analizohet në detaje ky pretendim.

2. Një inxhinier i diplomuar i Arkitekturës ose master I Arkitektures me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion.

2. CV-ia, diploma e noterizuar, dëshmi mbi përvojën në punë, Kontrata e punës ose kontrata e bashkepunimit për këtë projekt me OE në fjalë e noterizuar.

(Arkitekti zt.KV ka kontrate mbi vepër për projektin ne fjale me orar te plote por i njëjti sipas CV se prezantuar ka kontrate te plote edhe me një kompani tjetër)

3.Një inxhinier I diplomuar I elektroteknikes ose master I elektroteknikes drejtimi elektroenergjetike me jo me pak se 5 vite pervoje pune.

3. CV-ia, diploma e noterizuar, dëshmi mbi përvojën në punë, Kontrata e punës ose kontrata e bashkepunimit për këtë projekt me OE në fjalë e noterizuar.

(Ing elektro ka kontrate mbi vepër për projektin ne fjale me orar te plote por i njëjti sipas CV se prezantuar ka kontrate te plote edhe me një kompani tjetër). Ne dyshojmë se i njëjti nuk e ka edhe drejtimin e kërkuar elektro energjetikë.

4. Një inxhinier I diplomuar i Ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknik, apo master I Ndertimtarise drejtimi Hidroteknikë me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion

4.CV e nenshkruar nga vetë inxhinieri, diploma e noterizuar, dëshmi mbi përvojën në punë, Kontrata e punës ose kontrata e bashkepunimit për këtë projekt me OE në fjalë e noterizuar.

(Ing Hidro ka kontrate mbi vepër për projektin ne fjale me orar te plote por i njëjti sipas CV-së të prezantuar ka kontrate te plote edhe me një kompani tjetër). Kjo është e palejueshme dhe jo ligjore të punojë me orar të plotë në dy kompani të ndryshme.

5.Nje inxhinier I diplomuar I makinerise dega termoenergjetike ose master I makinerise dega termoenergjetike me jo me pak se 5 vite pervoje pune.

5. CV e nenshkruar nga vetë inxhinieri , Diploma e Noterizuar , Kontrata ose Marrëveshja e punës për këtë projekt e noterizuar,

(Ing makinerisë **ka kontrate mbi vepër për projektin ne fjale me orar te plote por i njëjti sipas** CV se prezantuar **ka kontrate te plote edhe me një kompani tjetër)**

7.Nje specialist **salidimi I certifikuar me IËS nga IIË .**

7. CV e **nenshkruar nga vetë specialisti , Diploma ose qertifikata e noterizuar , Kontrata e** punës ose **kontrata e bashkepunimit për këtë projekt me OE ne fjale e noterizuar .**

Salduesi **zt.Luan Berisha posedon certifikatë pa afat te skadencës, ndërsa kur analizohen certifikatat tjera të prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë shihet qartë se të tjerëve ju figurojnë edhe datat e skadencës së licencës.**

9. Një **Inxhinier në Menaxhimin e Emergjencave – min 3 vite përvojë pune pas Diplomimit .**

9. CV e **nenshkruar nga vetë inxhinieri , Diploma e Noterizuar , Kontrata ose Marrëveshja e** punës **për këtë projekt e noterizuar,**

(Ing emergjencave **ka kontrate mbi veper per projektin ne fjale me orar te plote por I njejti** sipas CV **se prezantuar ka kontrate te plote edhe me nje kompani tjeter)**

Kërkesa **5. Të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike**

Ngarkues **mbi 20 ton. Një ngarkues eshte me pesh 20.000, nuk është mbi 20 ton, prandaj është** i papërgjegjshëm, **sepse kërkesa ka qenë mbi 20 Tonë e jo 20 tonë.**

OE SHED **SH.P.K** është i papërgjegjshëm për shkak se nuk ka plotësuar asnjë kërkesë të dosjes së tenderit dhe atë si në vijim:

- I njëjti OE nuk ka ofruar dëshmi për qarkullim në tri vitet e fundit në vlerë prej 1,320,000.00 €.
- Nuk ka ofruar dëshmi për kapital financiar nga banka në vlerë 300,000.00 €.
- **Nuk ka ofruar dëshmi për kontrata në vlerë prej 990,000.00 €.**

Nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesës për stafin, referenca, diploma, CV, certifikatat për :

- Inxhinierin e diplomuar të elektroteknikes ose master i elektroteknikes drejtimi elektroenergjetike
- Inxhinierin e diplomuar të makinerisë dega termoenergjetike ose master i makinerise dega term energjetikë
- Inxhinierin e ndërtimit
- Inxhinierin e ndërtimit drejtimi Hidroteknike
- Inxhinierin e arkitekturës
- Inxhinierin e gjeodezise
- Specialistin e saldimit i certifikuar me IËS nga IIË
- Specialistin ose teknik i certifikuar (trajnuar) për CCTV
- Inxhinier në Menaxhimin e Emergjencave
- Armiruesin nuk ka ofruar asnjë dëshmi, as certifikatë
- Instaluesin elektrik
- Teknik të ndërtimtarisë
- Teknik të Hidro ndërtimit
- Nuk ka ofruar Raportin e vlerësimit të riskut
- Nuk ka ofruar asnjë dëshmi për makineritë e kërkuara.
- Mungon Sigurimi i tenderit.
- Mungojnë Iso certifikatat e kërkuara

Vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me dt.21.02.2025, mirëpo i njëjti vendim është i paqëndrueshëm sepse në asnjë mënyrë nuk janë dhënë fakte apo dëshmi konkrete për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.
Arsyetimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është dhënë si në vijim:

Autoriteti Kontraktues, me dat.21. 02. 2025 , ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka vendosë që kërkesa juaj për rishqyrtim të refuzohet si e pabazuar për arsyet në vijim:

1. **Është fakt i pamohueshëm se AK gjat procesit të rivlerësimit ka vepruar në plotni me rekomandimet e nxjerra nga vendimi i OSHP së i cili OE tani të të propozuar nga ana jonë e nxjerr të përgjegjshëm në të gjitha pikat në të cilat ne më parë e kishim kontestuar.**
2. **Gjithashtu është bërë edhe rivlerësimi i ofertës tuaj dhe tani nga një OE i papërgjegjshëm e keni statusin e OE të pasuksesshëm sepse keni çmim më të lartë se OE i propozuar për kontratë.**
3. **AK me rastin e vendimarrjes ka rrespektuar nenin 1 të LPP së i cili ka TË BËJ ME MBROJTJEN E PARASË PUBLIKE.**
4. **Nuk qëndron asnjë pretendim i juaji lidhur me papërgjegjshmërin e OE të propozuar për kontratë.**

Nga ky arsyetim vërehet se AK-së nuk është munduar fare që të jep përgjigje për pretendimet tona ankimore por është mjaftuar që vetëm me një fjali të jep përgjigje dhe të përmbyll arsyetimin e vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, prandaj konsiderojmë se në këtë rast nuk është respektuar neni 108/A paragrafi 9 i LPP-së, ku shkruan qartë:

9.*Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim.*

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, përkitazi me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, prandaj duhet rishqyrtuar edhe njëherë ky aktivitet i prokurimit me të gjitha dëshmitë e ofruara.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.2 i LPP-se sepse është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik i papërgjegjshëm.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa neve jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse"*, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as

kësaj dispozite ligjore sepse oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

VENDIM

I. **APROVOHET**, e bazuar ankesa e grupit të OE **EBK SH.P.K.**
II. **ANULOHET**, njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM**
III. **DETYROHET** autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

v10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*